REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.1325 Prot

Maliq, më 02.03.2026

VENDIM
Nr. 25, datë 27.02.2026

"Për miratimin e proces verbalit të datës 08.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Maliq"

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 53 pika 8, neni 54 gërma "k" si dhe nenit 88, i Rregullores të fuksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë proces verbalin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 08.01.2026 bashkangjitur.

2.Kopja e proceverbalit të miratuar administrohet nga Sekretari i Këshillit sipas procedurave ligjore.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.03.2026

NË MUNGESË

DHE ME POROSI

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT

Enida AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 08.01.2026 Prot.48 (dyzetëetetë)

Protokoll nr. 48

I mbajtur sot më datë 08.01.2026, në mbledhjen e jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. P-V "Mbi plotësimin e dokumentacionit dhe detjaimin në buxhetin e bashkisë Maliq të vitit 2026 për fondin e Emergjencave Civile dhe Mbetjeve Urbane";
4.P-V "Për detajim fondi të grantit bazuar në perfomancën e bashkive për vitin 2025 me burim financimi nga buxheti i shtetit";
5. P-V "Për detajim fondi të grantit bazuar në perfomancën e bashkive për vitin 2025 me burim financimi nga buxheti i shtetit";
6-P-V "Për miratim fondi i projektit të fituar me Ministrinë e Shëndetësisë për "Shërbimin në familje për të moshuarit për personat me aftësi ndryshe";
7.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Floreta Zaçe; Marinathi Avrami; Idlir Limllari; Klea Baçi;Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Dritan Çami; Selami Muço; Kela Baçi; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Xhuana Hoxhallari; Eriseld Jonusllari; Enida Avdolli; Andonaq Risto; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Server Xhuti; 20(njëzetë) këshilltarë.

Mungesa: Aramando Dautllari; Dalina Krekas;Almir Elezi; Rovena Terolli; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Marjeta Xhelollari; Neresida Shindo;11 (njëmbëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti.

Ornildi Demollari: Mirë, mirëdita të gjithëve, mirëdita, mirëdita të gjithëve të nderuar kolegë. I nderuar kryetar, të nderuar pjesëmarrës, sikurse jeni njoftuar, kemi thirrur këtë mbledhje jashtë radhë, e kërkuar nga nga kryetari i bashkisë, me kërkesë të kryetarit të bashkisë, me rend dite prej shtatë pikash. Besoj me materiale dhe me rendin e ditës jeni njohur disa ditë përpara, kështu që mund të vijojmë pasi të verifikojmë korumin. Dhe korumi realizohet sepse janë gjashtëmbëdhjetë këshilltarë në sallë, ndërkohë që po vijnë edhe disa të tjerë, por mund të vijojmë. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, duke shtuar edhe këtë, këtë projekt vendim që solli kryetari. Tani, kush është dakord me rendin e ditës? 18 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Ju më lejoni t'ju rikujtoj konfliktin e interesit në qoftë se ndonjëri nga ne kolegë ka. konflikti interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutim dhe as në votim. Dhe kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës, që është projektvendim mbi disa plotësime dhe detajime të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Për fondin e emergjencave civile dhe mbetjeve urbane, lutem komisioni po

Petrit Kupe:Përshëndetje të gjithëve dhe i uroj një vit të mbarë.Dy mijë e njëzet e gjashtë. Si gjithmonë, komisioni u mblodh në praninë e kryetarit të bashkisë dhe shqyrtoi gjithë tre projekt vendimeve. Të cilët janë të rëndësishëm për fillimin e vitit të aktivitetit financiar të bashkisë. Këto kanë ardhur si rezultat i disa ndryshimeve që kërkohet nga prefektura. Por edhe për shkak të ardhjes së një granti të konsiderueshëm, për shkak të përfitimit të një granti në performancë të bashkisë. Pothuajse të provej vendime janë shqyrtuar edhe në mbledhjen e buxhetit, po shkurtimisht do bëhen disa ndryshime për shkak të fondeve, për shkak të moskonfirmimi nga prefektura, megjithatë, ne, meqënëse janë të shqyrtuar, mendojnë t'i kalojnë shpejt dhe ne nuk po flasim më gjatë si komision, mbasi i shqyrtuam. Dhe ramë dakord me argumentat që kryetari na ngriti para komisionit për të bërë këto ndryshime. Pra, kërkojmë që këto të miratohen në mënyrë telegrafike. Sepse janë në përmirësim të punës të buxhetit të bashkisë. Faleminderit, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Përshëndetje të gjithë dhe faleminderit. Dua t'ju shpjegoj disa kthime të bëra nga institucioni i prefektit. Ka një problem në lidhje me miratimin me tarifat në kullotat. Për të cilat ne kemi mbështetur një vendim qeverie, i cili është shfuqizuar. Institucioni i Prefektit na i ka vënë në dispozicion. Edhe ne kemi bërë këto ndryshime në paketë, janë vetëm disa rregullime të saj. Ka një dy anomali në pozicionet përgjegjëse sektorësh. Të cilat ne i kemi paguar me pagë gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë dhe minimalja e pagesës është shtatëdhjetë e lartë. Kështu që kemi bërë dy-tre rregullime të cilat na kanë kaluar. Dhe problemi i dytë ka të bëjë me fondin e mbetjeve urbane, i cili në buxhet është si transfertë më vete i çelur nga parlamenti, nga qeveria. Ne e kemi bashkuar me transfertën e përgjithëshme të bashkisë. Nuk ndryshon gjë në fondin e përgjithshëm. Por vetëm si detajim e kemi çuar si detajim vetë te menaxhimi i mbetjeve urbane, shtatë pikë gjashtë milionë lekë. Dhe propozimi tjetër ka të bëjë me një njësim të pagave, duke qenë që ende nuk është miratuar ndryshimi i fondit të pozicionit të pagave për të gjithë punonjësit dhe është duke u punuar. Kishte një njësinë të pagave midis punonjësit të thjeshtë dhe të themi drejtuesit të një sektori apo brigadierit. Kështu që në këtë aspekt, ne ju propozojmë si moment të parë uljen me një orë pune të gjithë punonjësve dhe edhe

pse ata marrin rritje pagash për efekt të pagës minimale në varësi të numrit të orëve të punës që kanë. Por tek e përgjithshmja bëhet edhe një rregullim i hierarkisë, të themi, të tyre me njëri-tjetrin. Nga këto ndryshime të cilat folëm, kemi një ulje të fondit të pagave me rreth 9.8 milionë lekë. Kemi një shtim të fondit të investimeve, nga dyzet e pesë në pesëdhjetë e një milionë lekë, po të shtojmë këtu dhe dhjetë pikë pesë milionë lekë, e cila vjen si grant performancë për punën e mirë të bashkisë, ne kemi konkurruar me programet tona në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe jemi shpallur, nga bashkitë që ka fituar fonde të konsiderueshme nga më të mirat në Shqipëri, me dhjetë pikë pesë milionë lekë. Edhe këtë e shtojmë për sistemim asfaltim rrugë në vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Është rregullimi i mirë i investimeve dhe në totalin e përgjithshëm, investimet nga njëqind e shtatë milionë dhe njëqind e pesëmbëdhjetë milionë. Këtu nuk hyn një pjesë e performancës nga fondet me financim të huaj, por Ministria e Financës kërkon një miratim nga ana e Këshillave Bashkiak para se t'i çelë këto fonde. Pasi vendimi i qeverisë dhe udhëzimi nuk lejojnë që këto fonde të përdoren për paga edhe për shpërblime, por për çdo gjë mund t'i përdorë bashkia dhe këshilli bashkiak. Ja u kemi propozuar për t'i përdorur për investime në rrugë. Ju propozojmë të shtojmë dhe një milion lekë të reja për mbrojtjen civile, ajo që cilën folëm dhe për cilën kërkojmë. Që t'i kalojmë përmarrje mjete me qira, pasi situatën e kemi të vështirë dhe nuk dimë si do jetë dimri në vazhdimësi, si për rreshje, si për dëborë. Ndaj dhe iu sollëm një projektvendim të shpejtë. Dhe mbrojtja civile nga katër milionë shkon në pesë milionë, dhe në totalin e përgjithshëm shkojmë njëzetë katërqind e shtatëdhjetë, duke e rritur me një milionë lekë këtë zë në buxhet. Kaq është me pak fjalë ndryshimi që ju propozojmë në totalin e përgjithshëm, shifrat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të madh, përveç këtyre dy-tre rregullimeve që u thamë. Dhe në totalin e përgjithshëm, i gjithë projektvendimi rakordohet plus minus me fondet që kemi folur dhe në mbledhjen e fundit, ku miratuan buxhetin. Në qoftë se keni ndonjë pyetje konkret, jam i gatshëm t'ju vij.

Ornildi Demollari: Ka pyetje? Ka ndonjë gjë të paqartë tek kjo pjesë, e kalojmë votim atëherë pikën tre. Detajim në buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2006 për Fondin e emergjencave civile dhe mbetjeve urbane. Kush është dakord?17 vota pro.
Kundër ? Dy kundër.Eglantina Balli, Server Xhuti.Atëherë me gjashtëmbëdhjetë vota pro dhe dy kundër, miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika e katërt e rendit të ditës, që është projektvendim për detajim fondit të grandit të bazuar në performancën. Për bashkinë, për bashkitë për vitin dy mijë e njëzet e pesë, me burim financimi nga buxheti i shtetit, pika katër.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë e përmenda pak më lart janë dy projektvendime, një që fondet e performancës mbulohen nga buxheti i shtetit, dhe ne jemi shpallur fitues për 4.5 milionë lekë. E keni projektvendimin me shifrën e saktë? Edhe një është për financimin e huaj. Të dyja ne ia propozojmë këshillit për t'i çuar në investime në rrugë për vitin 2026. Dhe ia bashkë, ia shtojmë fondit të investimeve në rrugë për këtë qëllim ka pyetje këtu.

Ornildi Demollari: Petrit, kini gjë ju? Dakord, e kalojmë në votim pikën katër. Kush është dakord? 17 vota pro

Kundër? Një, tjetër kundër ka?Eglantina Balli. Me shtatëmbëdhjetë pro dhe një kundër, miratohet pika katër. Faleminderit. Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, projektvendim për detajim fondit të grantit të bazuar në performancën për bashkitë për vitin dy mijë e njëzet e pesë, me burim financim nga buxheti i shtetit. Po e njëjta.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është një pjesë nga donatorët dhe një pjesë nga buxheti i shtetit, pjesa që është me financim të huaj. E kërkon detyrimisht një vendim këshilli, përpara se ata ta çelin fondin, se duan që ky fond të shkojë në investime, ose jo në paga, jo në shpërblime, për të cilat ne nuk kemi.

Ornildi Demollari:Është ajo që folë domethënë, ajo që the pak mbrapa. E kalojmë votim pikën pesë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? 1 kundër. Eglantina Balli. Miratohet me shtatëmbëdhjetë pro, një kundër miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, projektvendim për miratim fondi i projektit të fituar nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimin në familjet për të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe. Po, Eermanda, drejtoreshë, po.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje, fondi që kemi kërkuar për miratim është mënyra e përdorimit të fondit për projektin e shërbimeve mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuar dhe personat me aftësi të kufizuar është viti i katërt që ne mbështetemi nga Fondi Social për realizimin e këtij projekti. Më poshtë kemi detajuar edhe mënyrën e përdorimit të tij. Ku do të jetë një punonjës dhe pjesa tjetër do të jetë shpenzime operative dhe materiale të tjera të nevojshme për realizimin e këtij projekti.

Ornildi Demollari:Është vazhdimësi e asaj që kemi pasur.

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti:Është vazhdimësia e projektit të tre viteve të kaluara. Ky është viti i katërt që prej që Ministria e Shëndetësisë na mbështet me tridhjetë përqind të fondit të kërkuar.

Ornildi Demollari: Edhe këtë vit po tridhjetë për qind?

Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti Po tridhjetë për qind.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë votim, atëherë kush është dakord? 19 vota pro. Kundër? Nuk ka, asnjë kundër. Me tetëmbëdhjetë vota pro. Miratohet faleminderit. Tani shkojmë tek projektvendimi që na solli kryetari për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile, kalojmë tek ndryshimet në strukturën e. E vitit dy mijë e njëzet e gjashtë, pastaj shkojmë tek kjo, tek struktura. Komisioni i financës, ne i kemi të ndarë në rendin e ditës.
Petrit Kupe: Ne e pamë bashkë në buxhetin dhe strukturën dhe buxhetin, kështu që,

Ornildi Demollari: Po se në rend dite kemi, e po është bashkuar, detajimet e buxhetit për emergjencat civile dhe mbrojtjet dhe mbetjet urbane. Kështu e kemi. Të lutem ta kalojmë edhe një herë në votim strukturën. Ndryshimet në strukturë, kush është dakord?17 vota pro.
Kundër? Një kundër, Eglantina Balli.Miratohet faleminderit. Tani shkojmë tek projvendimi që na erdhi së fundi për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga të ardhurat e veta. Është ajo për blerjen e përmarrjen e me qera të mjeteve për emergjencat dimërore. Ka ndonjë pyetje? Ka nevojë për shpjegim, kryetar do të shpjegosh diçka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po duke marrë shkas nga situata që kemi, edhe shtrirja shumë e madhe territoriale që kemi në të gjithë bashkinë. Pavarësisht mjeteve që ne kemi në dispozicion, ndodh që në të njëjtën kohë, në të njëjtën pikë, në të njëjtin moment, kërkohen mjete në shumë vende. Sado që të të maksimalizojmë mjetet tona, forcat tona mund të na dalë e nevojshme gjatë gjithë ditëve për efekt të rreshjeve, për efekt të borës. Dimri është përpara, ndaj dhe po i paraprijmë këtij momenti duke kërkuar miratimin nga fondet tona të emergjencave civile të një fondi një milion lekë për efekt marrje mjete me qira dhe përdorimi rast pas rasti sipas nevojës tonë. E kemi përdorur edhe herë të tjera, na ka dhënë rezultat. Dhe unë them që ta miratojmë dhe jemi një plus në punën tonë në rendimentet e punës sonë dhe rezultatin e punës. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje? Po.

Faslli Zholi: Përshëndetje, faleminderit. Duhet të falenderoj të gjithëve për këtë takim, që edhe mbledhjet jashtë radhe që bëmë, se kemi caktuar edhe një datë tjetër. Natën katërmbëdhjetë dhe për këtë pikë, unë mendoj se situata është shumë e vështirë. Siç e shikoni, edhe përmbytjet, edhe dëbora. Dhe jam dakord që të merren edhe ato, se kur s'ke mundësinë ta bësh me ato që ke, do të bëhesh të patjetër që do të kërkosh edhe privati për të marrë mjet apo për të marrë të ardhur ndihmë të kësaj situate. Unë i ftoj të gjithë këshilltarët të jemi të kujdesshëm sa herë të kërkojë edhe ekzekutivi në këto situata, të jemi në këmbë, të mos mungojmë, qoftë edhe ditën e hënë që kemi bërë edhe për këto situata që janë këto, këto. Të vijnë dhe po shtohen, inshallah Zoti të vërë edhe dorë, që mos të ketë. Është fatkeqësi me gjithë mendjen e rëndë. Faleminderit të gjithëve dhe mendoj që këtë ta miratoj.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kryetar mund të shpjegojë diçka, meqë jemi në këtë situatë, telegrafisht mund t'ju jap një informacion mbi rreshjet e datës shtatë, të cilat kanë qenë nga më të mëdhatë në të gjithë vendin. Nga shërbimi meteorologjik ushtarak, në datën shtatë të parë, në njëzet e katër orë ka rreth njëqind e njëzet e katër milimetra shi më e madhja në të gjithë Shqipërinë, edhe pse parashikimet na japin një situatë jo shumë kaq agresive në territorin tonë. Në fakt, shifrat flasin ndryshe dhe do të thotë që të, po marr vetëm Maliqin, sikur të marrim pesë mijë hektarë, sasia e rreshjeve të rëna është. Konsiderohet në nivelin shumë të lartë sipas meteorologëve gjashtë pikë dy miliardë litra ujë apo gjashtë mijë e dyqind metra kub ujë në këtë territor. Dhe sot në hidrocentralin e Moglicës s'ka ndodhur ndonjëherë derdhen pesëqind metra kub ujë në sekondë. Sipas matjeve shumëvjeçare, ky është një rekord i cili na vë në një pozicion

të vështirë, duke marrë në konsideratë edhe tejmbushjen, tejngopjen e tokës. Nga rreshjet e muajit nëntor na kanë nxjerrë në një situatë shumë të vështirë, për të cilën mendojmë ta përballojmë me forca të shtuara dhe patjetër. Kemi nevojë edhe për këshillën e bashkisë, për vendimarrjet e tyre, edhe për për t'i dhënë. Shyqyr Zotit ndodh që s'kemi probleme në njerëz. S'kemi probleme në banesa, por duhet të jemi në këmbë të gjithë për ta përballuar këtë situatë. Shumë faleminderit të gjithëve.

Ornildi Demollari: Sa kalojmë në votim këtë pikën, kush është dakord?19 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka, miratohet. Faleminderit. Tani kemi diskutime të tjera në qoftë se ka ndonjë gjë tek diskutimet e tjera. Le të shpresojmë që situata me reshje të kalojë sa më me më pak demet. Dua t'ju rikujtoj që ditën e hënë kemi thirrur një mbledhje tjetër jashtë radhe, enkas për dëmtimet nga reshjet. Ditën e hënë në ora dhjetë, ndërkohë kisha dhe një propozim për këshillin për disa ndryshime në komisionin e bujqësisë, ku propozojmë që kolegu jonë Selami Muço të shkojë tek komisioni i bujqësisë, në qoftë se do. Dhe të të rregullohet pastaj e di sekretari se si do ta, se si do ta rregulloj. Desha një dakord si kështu në parim, jemi dakord që Seloja të shkojë tek Komisioni i Bujëqsisë dhe ku ka vakanca.
Miratohet me 19 vota pro.Ndryshimi.

Faleminderit edhe ditë të mbarë në vijim.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

P. Enida Avdolli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ